



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari Komunës propozon :

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 8, 12 deri në 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.08 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës ____2014, miratoi këtë

PROJEKT

RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për taksat komunale (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal.

Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohen taksat komunale, obliguesit, procedura e pagesave si dhe procedura e ankesave, si vijon:

1. Taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare ,
2. Taksa administrative për Leje Mjedisore Komunale
3. Taksa për pronësin e automjeteve motorike,
4. Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike,
5. Taksa për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën komunale,
6. Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Rini, Sport dhe Kulturë,
7. Taksa për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksi,
8. Taksa për antena të telefonisë mobile dhe të internetit

Neni 3
Taksat tjera dhe bashkëpagesat

1.Taksat për leje ndërtimore do të përcaktohen nga Drejtorati për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit konform nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për ndërtim Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18 e datës 03.07.2012.

2.Taksat tjera të përcaktuara me dispozita ligjore, bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi, tarifat për shërbimet dhe produktet kadastrale, taksat për regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtëshme, të cilat sipas kompetencës i përcaktojnë Ministritë e Qeverisë të Republikës të Kosovës, do të aplikohen nga organet e Komunës në pajtim të dispozitave ligjore dhe udhëzimeve përkatëse administrative.

Neni 4
Fushëveprimi

Taksat e përcaktuara me këtë rregullore i zbatojnë organet e administratës dhe institucionet tjera komunale, nëse me dispozita ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 5
Obliguesit

Obligues për pagesën e taksave të përcaktuara me këtë rregullore janë personat fizik dhe juridik me rastin e parashtrimit dhe zgjidhjes së kërkesave të tyre nga fushëveprimi i organeve të administratës dhe institucioneve tjera të Komunës.

II. TAKSAT

Neni 6
Taksa administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare

1.Këto taksa caktohen për lëshimin e këtyre dokumenteve :

Nr.	EMËRTIMI I DOKUMENTIT	SHUMA
1	Ekstrakti dhe certifikata e lindjes, certifikata e martesës dhe vdekjes, certifikatat dhe vërtetimet tjera, nëse me akte tjera dhe këtë Rregullore nuk është përcaktuar shumë tjetër e taksës	1 €
2	Certifikata për gjendjen martesore	2 €
3	Aktvendimi për ndërrimin e emrit personal	10 €
4	Aktvendimet për regjistrime të mëvonëshme në Regjistrat e Gjendjes Civile	3 €
5	Korigjimet e shënimeve në Regjistrat e Gjendjes Civile	3 €
6	Certifikata për bashkësin familjare	2 €
7	Akt vdekjeje	5 €
8	Ceremonia e kurorëzimit në Zyren e Komunës	10 €
9	Ceremonia e kurorëzimit jashtë Zyrës së Komunës	70 €
10	Konfirmimi i të dhënave për personat e mbajtur nga personi në botën e jashtme	8 €
11	Konfirmimi i të dhënave për realizimin e shtesave femërore në botën e jashtme	8 €
12	Vërtetimi i nënshkrimeve në deklaratat e palëve – për çdo nënshkrim nga	1 €

13	Fotokopjimi dhe vërtetimi i kopjes së origjinalit të prezentuar nga pala për çdo faqe të shkruar nga	1 €
14	Lëshimi i kopjeve nga dokumenti origjinal që e posedon organi komunal për çdo faqe të shkruar nga	1 €
15	Leja për prerje në pyjet private	10 €
16	Pjesëmarrja në Ankande publike	20 €
17	Çertifikimi i Objektivit mbi plotësimin e kushteve minimale – teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste – deri në 100 m/2	25 €
18	Çertifikimi i Objektivit mbi plotësimin e kushteve minimale – teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste – mbi 100 m/2	50 €
19	Aktvendimet tjera nëse me dispozita tjera dhe këtë Rregullore nuk është përcaktuar shumë tjetër e taksës	3 €
20	Kërkesat për rishqyrtim dhe Ankesat	1€

2. Nga obligimi i pagesës së taksave nga paragrafi paraprak, janë të liruar: anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, Invalidët e luftës së UÇK-së, studentët për ndihmë financiare nga subvencionet dhe personat të cilët kërkojnë ndihmë financiare nga subvencionet për trajtim shëndetësor

Neni 7

Taksat administrative për Leje Mjedisore Komunale

Taksat administrative për Leje Mjedisore Komunale janë të obliguar ti paguajnë aplikuesit për Leje Mjedisore Komunale për ushtrimin e veprimtarive në objektet, si vijon:

LISTA E AKTIVITETEVE	Njësiti në €
1. Autoserviset; Autolarjet; Sharrim i lëndës drunore; Fabrikat për perpunim druri, mobileri, tapiceri deri 1000 m ³ /vit; Thertore me kapacite deri 3 gjedha /ditë; Magazinimi i lubrifikantëve të ambalazhuar, në vendëprodhim; Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri në 500 kg/ditë; Rritje artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 m ² ; Punishtet e vogla për perpunim të mermerit, me sipërfaqe totale- objekti deri në 200 m ² ; Furra për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit; Qebaptoret dhe gjellto;e;	1 €/m ²
2. Stacionet e karburanteve të benzinës me kapacitet deri 49m ³ ; Pikëshitjet e gasit (GLN) deri 4.9 m ³	3 €/ m ³
3.Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj;	1 € /ha
4. Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral mineral; me kapacitet deri ne 0.5 m ³ ne ditë; Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash, pije freskuese; pijesh alkolike me kapacitet deri në 0.5 m ³ në ditë;	0.5 € / litër
5. Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km; Rehabilitimi i ujësjellesve egzistuese në gjatësi deri 5 km	0.03 € / m
6. Rikonstrukcion i rrugëve urbane dhe rurale egzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km);	0.05 € / m
7. Fabrika për perpunim të qumështit dhe produkteve të tijë, deri 1000kg/ditë; Fabrika për perpunim të pemëve dhe perimeve, deri ne 1000kg/dite;	0.1 € / kg
8. Fabrika për perpunim të vajrave bimore, luledielli, etj. me kapacitet 500 l/ditë	0.2 € / litër

9. Prodhimi i gëlqeres (shuarja) deri 100 ton/vit:	1 €/ton
10. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. me kapacitet deri në 50 m ³ beton/ditë;	2 €/m ³
11. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktiv demolimit për qëllime të riciklimit përfshirë seleksionimin, coptimin mekanik dhe deponimin e tyre si dhe caktimin e vendit për deponim;	1.5 €/ton
12. Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjajshëm, pa procese kimike (qepje, ngjitje montim);	2 €/m ²
13. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000m ² .	0.20 €/m ²
14. Plantacionet e drurëve frutore	10 €/ ha
15. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri ne 100m ³ ose 40 ton gjatë vitit	2.5 €/ton
16. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri në 10 ton; Vendet ku janë të magazinuara, më pak se 10 ton mbeturinë inerte;	10 €/ton
17. Vendet ku janë të magazinuara, më pak se 2 ton mbeturinë e pa rrezikshme	20 €/ton
18. Vendet e tregtimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura; Tregjet urbane industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore; Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit	0.03 €/m ²
19. Magazinat frigorifer, për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri ne 50 ton.	2 €/ton
20. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000 t/vit	0.5 €/ton
21. Impiantët për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se: 1). 2000 shpend; 2). 100 derra; 3). 30 gjedha; 4) 200 bagëti të imëta.	0.10 €/ krerë shpend 1€/ krerë derra 3 €/ krer gjedhë 1 €/ krerë bagëti të imëta

Neni 8

Taksa për pronësin e automjeteve motorike

1.Obligues të taksës për pronësin e automjeteve motorike janë pronarët e automjeteve motorike: personat fizik të cilët janë banorë të Komunës, shoqëritë e regjistruara tregtare, dhe shoqatat joqeveritare që kanë selinë në Komunë.

2. Kjo taksë përcaktohet dhe paguhet në shumë vjetore me rastin e regjistrimit të automjeteve, si vijon:

Nr.	Lloji i automjetit	Taksa
1	Automjetet me peshë deri në 3.5 tonë	10€
2	Automjetet me peshë mbi 3.5 tonë	20 €

3.Të liruar nga pagesa e kësaj takse për automjetet që i kanë në pronësi, janë:

Organizata e veteranëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e familjeve të dëshmorëve të luftës të UÇK-së, Kryqi i kuq Komunal, Shoqata

”Handikos”, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së dhe invalidët e luftës së UÇK-së.

Neni 9

Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike

1. Këto taksa i aplikon Drejtorati i Shërbimeve Publike, në bazë të kërkesës të subjekteve afariste për dhënien e Lejes për shfrytëzim me afat të caktuar të hapësirave komunale për vendosjen e objekteve lëvizëse dhe sezonale.

2. Drejtorati i Shërbimeve Publike, para nxjerrjes së Vendimit për dhënien e Lejes për shfrytëzim, me konkluzion vendos dhe kërkon paraprakisht nga parashtruesi i kërkesës përmbushjen e obligimit të pagesës.

3. Lartësia e obligimit përcaktohet për kohëzgjatjen të shfrytëzimit të sipërfaqes publike e përcaktuar në Lejen për shfrytëzim, si vijon :

Nr.	EMËRTIMI DHE VEPRIMTARIA	BAZA	SHUMA
1	Paisjet për shitjen e akulloreve, pofkave, misrit, gështenjëve dhe të ngjajshme. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	5 €
2	Dhënia në shfrytëzim e sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarin e cila është e lejuar të ushtrohet jashtë objektit dhe ekspozimin e mallrave të lejuara. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore.	m ²	1 €
3	Objektet e përkohëshme lëvizëse dhe sezonale - konstrukcionet për lorjra dhe të lunaparqeve. Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	0.50 €
4	Tavolinat lëvizëse për shitjen e urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, dhe të ngjajshme . Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	1 €
5	Promovimi i produkteve të biznesit . Ngarkesa llogaritet në bazë ditore	m ²	0.50 €
6	Panot dhe tabelat reklamuese - Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	m ²	50 €

Neni 10

Taksa për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën komunale

1. Obligues të pagesës të këtyre të taksave janë pronarët e objekteve, të lokaleve të përkohëshme dhe qoshqeve të vendosura me lejet përkatëse në pronën Komunale.

2. Shuma e ngarkesës llogaritet në bazë vjetore, për çdo vit kalendarik, për çdo m² të sipërfaqes së objektit .

3. Vendimet mbi obligimin e pagesës i nxjerr Drejtorati për Shërbime Publike dhe ua dërgon obliguesve para fillimit të çdo viti kalendarik., sipas shumave të përcaktuara në vijim:

Nr	OBJEKTI DHE VEPRIMTARIA	VENDI	BAZA	SHUMA
1	Lokalet – objektet e përkohëshme për kryerjen e veprimtarive zejtare, shërbyese dhe hoteliere, ekonomike, për shitjen e prodhimeve industriale, bujqësore dhe gjërave tjera ushqimore, si dhe objekte tjera të ngjajshme	Zona e I-rë	m ²	10 €
		Zona e II-të	m ²	7 €
		Zona e III-të	m ²	3 €

2	Qoshqet për shitjen e gazetave, revistave, duhanit, librave, lotarive, bizhuterive, suvenireve, bukës dhe brumërave.	Zona e I-rë	m ²	8 €
		Zona e II-të	m ²	5 €
		Zona e III-të	m ²	2 €

Neni 11

Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Rini, Sport dhe Kulturë

1. Këto taksa i aplikon Drejtorati për Rini, Sport dhe Kulturë, me rastin e parashtrimit të kërkesës të subjekteve të regjistruara për dhënien në shfrytëzim të objekteve , sipas skemës tarifore në vijim :

Nr.	Emërtimi	Shuma
1	Shfrytëzimi i sallave	50 € / h
2	Shfrytëzimi i objekteve sportive	10 € / h
3	Anëtarësimi në biblioteka në bazë vjetore	1€

2.Nga pagesa e taksës numër 2 lirohen klubet e Komunës të cilat garojnë në ligat përkatëse sportive.

Neni 12

Taksa për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksi

1.Taksën për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksi, janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë autotaksi, për secilin automjet në shumë vjetore në lartësi prej 50 € .

2. Faturat për pagesën e obligimeve nga paragrafi 3 i këtij neni i përgatitë dhe ua dorëzon obliguesve të kësaj takse - Drejtorati i Shërbimeve Publike, për secilin vit kalendarik, më së largu 1 muaj para fillimit të vitit të ri kalendarik.

Neni 13

Taksa për antenna të telefonisë mobile dhe të internetit

1. Taksën për vendosjen e antenave të telefonisë mobile janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë të telefonisë mobile për secilën antenë të vendosur në territorin e Komunës në bazë vjetore në lartësi prej 100 €.

2. Taksën për vendosjen e antenave të internetit janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë të internetit për secilën antenë të vendosur në territorin e Komunës në bazë vjetore në lartësi prej 30 €.

3. Faturat për pagesën e obligimeve nga paragrafët paraprak të këtij neni i përgatitë dhe ua dorëzon operatorëve ekonomik- Drejtorati i Shërbimeve Publike për secilin vit kalendarik më së largu 1 muaj para fillimit të vitit të ri kalendarik.

III. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 14

Detyrat e organeve komunale

1. Organet komunale, sipas fushëveprimtarisë së tyre, janë të obliguara që të zbatojnë dhe të inkasojnë taksat nga personat fizik dhe juridik sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që për dinamikën e realizimit të të hyrave buxhetore sipas kësaj Rregulloreje të informojë Kuvendin e Komunës për çdo tremujor.

Neni 15 Detyrat e obliguesve

Obliguesit kanë për detyrë të paguajnë shumat e caktuara të taksave sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara me këtë Rregullore, përkatësisht në bazë të aktit të Organit përkatës së Komunës për përcaktimin e obligimit të pagesës.

IV. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 16 Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

1 Obliguesi, i pakënaqur me llojin dhe lartësin e caktuar të taksës sipas kësaj Rregulloreje, përkatësisht me aktin e Organit të Komunës me të cilin është përcaktuar pagesa e obligimit, mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim ose ankesë në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative.

I. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për taksat dhe tarifat komunale 15Nr.434-4250 e datës 12.03.2013 me përjashim të nenit 4 par. 2 i cili mbetet në fuqi deri në zbatimin e nenit 3 par.1 të kësaj rregulloreje, përkatësisht deri më 31.12.2014 dhe Rregullorja për ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje 15Nr.434-10234 e datës 09.08.2013.

1Nr. _____
Lipjan , më _____

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

Arsyetimi

Projekti i kësaj Rregulloreje është i bazuar në dispozitat e neneve 8, 12 deri në 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 27 e datës 03.06.08 si dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr. 110-623 të datës 26.09.2008.

Me dispozitat e lartëcekura parashifet që Komuna përmes Rregulloreve komunale, për sigurimin e mjeteve vetanake buxhetore, mund të përcaktojë obligime me rastin e zgjidhjes së kërkesave të personave fizik dhe juridik për pagesën e taksave për kryerjen e punëve dhe shërbimeve nga Organet Komunale.

Me këtë Projekt parashifet aplikimi i taksave dhe tarifave si vijon:

1. Taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare ,
2. Taksa administrative për Leje Mjedisore Komunale
3. Taksa për pronësin e automjeteve motorike,
4. Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike,
5. Taksa për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën komunale,
6. Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Rini, Sport dhe Kulturë,
7. Taksa për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksit,
8. Taksa për antena të telefonisë mobile dhe të internetit

Taksat për leje ndërtimore më nuk parashifet të përcaktohen me rregullore, sepse konform nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për ndërtim, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18 e datës 03.07.2012, kjo taksë përcaktohet nga Drejtorati për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit.

Taksa tjera dhe bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi, nuk parashifet të përcaktohen me këtë rregullore, sepse ato janë të përcaktuara sipas kompetencës nga Ministritë përkatëse të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe aplikohen nga organet e Komunës në pajtim të udhëzimeve përkatëse administrative.

Lartësia e taksave është përcaktuar në bazë kostos së punës për shërbimet dhe aktivitetet që i ofronë Komuna, konform dispozitave të nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Projekti i kësaj Rregulloreje parashef disa ndryshime dhe harmonizime të taksave të parapara me Rregulloren aktuale për taksat dhe tarifat komunale 15Nr.434-4250 e datës 12.03.2013 dhe Rregulloren për ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje 15Nr.434-10234 e datës 09.08.2013.

Në Rregulloren aktuale, me nenin 6 parashifet taksa për leje për ushtrimin e veprimtarive afariste për marrjen dhe mbajtjen e Lejes dhe me nenin 7 taksa për leje për ushtrimin e veprimtarive profesionale të cilat janë aplikuar në pajtim me dispozitat e neneve 10 par. 10.1 dhe 11 par.11.1.

Dispozita e nenit 10 par. 10.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal i ka mundësuar Komunës, por nuk e ka obliguar, që të kërkojë nga bizneset të marrin leje për ushtrimin e veprimtarive afariste në lokalet të cilat ndodhen brenda Komunës, ndërsa dispozita e par. 16.2 e këtij neni të përcaktojë një taksë vjetore për marrjen dhe mbajtjen e Lejes afariste.

Poashtu në procedurë të njejtë konform nenit 11 par.11.1 dhe 11.2 Komuna ka mund të kërkojë nga shoqëritë tregëtare të cilat ofrojnë shërbime profesionale përmes një Rregulloreje të paisen me Leje për shërbime profesionale dhe ka mund të caktojë një taksë vjetore për marrjen dhe mbajtjen e Lejes për shërbime profesionale.

Duke marrë parasysh dispozitat e sipërcituara të cilat i mundësojnë Komunës aplikimin e taksave për Lejet e cekura, por nuk e obligojnë, me këtë Projekt rregullore më nuk parashifet

aplikimi i taksave për Leje për ushtrimin e veprimtarive afariste dhe Leje për shërbime profesionale.

Propozimi i lartëcekur ka për qëllim që bizneseve në Komunë të iu krijohen lehtësira financiare dhe procedurale – administrative për ushtrimin e veprimtarisë.

Në krahasim me Rregulloren dhe ndryshimet e Rregullores aktuale në fuqi, me këtë Projekt rregullore, përveq ndryshimeve për mos aplikimin e taksave për Leje për ushtrimin e veprimtarive afariste dhe Leje për shërbime profesionale, janë parapara kategoritë e liruara nga obligimi i pagesës së taksave për lëshimin e dokumenteve zyrtare – Neni 6 par.2 i cili thekson:

Nga obligimi i pagesës së taksave nga paragrafi paraprak, janë të liruara: anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, Invalidët e luftës së UÇK-së, studentët për ndihmë financiare nga subvencionet dhe personat të cilët kërkojnë ndihmë financiare nga subvencionet për trajtim shëndetësor.

Poashtu sipas neni 8. par.3 janë të liruara nga obligimi i pagesës së taksës për pronësinë e automjeteve: Organizata e veteranëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e familjeve të dëshmorëve të luftës të UÇK-së, Kryqi i kuq Komunal, Shoqata "Handikos", anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së dhe invalidët e luftës së UÇK-së.

Struktura e tekstit në Projekt Rregullore është sistemuar sipas kronologjisë të emërtimeve të taksave.

Dispozita e nenit 5 – Dhënia me qira e tokës bujqësore dhe objekteve nuk figuron sepse kjo qështje rregullohet me dispozita përkatëse.

Lidhur me taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare të parapara me nenin 8 (neni 6 i Projekt Rregullores) më nuk parashifen taksat me numër rendor 8, 17,18, 20, dhe 25. Numri rendor 1 dhe 2 është riformuluar si në numrin rendor 1, numri rendor 22 është riformuluar si në numrin rendor 15, ndërsa numri rendor 27 është riformuluar si në numrin rendor 20.

Taksa për shfrytëzim të përkohëshëm të objekteve për rini, sport dhe kulturë është riformuluar si në nenin 11.

1Nr. _____
Lipjan , më _____

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti